



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II nr.47/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditoritme seli në Pejë kundër debitorit Telekom i Kosovës sh,a nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.261/2019 të datës 01.07.2019, jashtë seancës me datë 23.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditoritme seli në Pejë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.261/19 të datës 01.07.2019, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.261/19 të datës 01.07.2019, e ka pranuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës sh.a në Prishtinë, dhe ka anuluar urdhërin për lejimin e përmbarimit privat P.nr.4/2019 dt.17.01.2019 të përmbaruesit privat Blerim Baloku nga Peja.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të shfuqizohet aktvendimi parë PPP.nr.261/19 të datës 01.07.2019, dhe të obligohet debitori ti bart shpenzimet e procedurës.

Përgjigje në ankesë nuk gjendet në shkresat e lëndës.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:
-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorime seli në Pejë, me datë 17.01.2019, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Telekom i Kosovës sh.a nga Prishtina, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave për borxh, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesave të faturave e gjer në pagesën definitive të borxhit kryesor, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Blerim Baloku nga Peja duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lejuar përmbarimin me urdhrin P.nr.4/2019 të datës 17.01.2019, ndërsa kundër këtij urdhri, debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar të gjitha faturat dhe borxhin e pretenduar se urdhëri për lejimin e përmbarimit nuk është i bazuar dhe nuk bazohet në prova. Faturat e prezentuara nga ane e debitorit janë të papranuara për arsye se të njëjtat janë kopje e jo në origjinal apo kopje të vërtetuara siq e parasheh ligji.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 04.02.2019, duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se faturat janë dokument i besueshëm, dhe se mos përmbushja e borxhit ndaj kreditorit dëshmohet edhe me konto kartel të kreditorit për debitorin ku shikohen qartë se në baze të cilave dokumente sa është borxhi i debitorit në përputhje me shumën e faturave.

Gjykata Themelore në Prishtinë pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.261/2019 të datës 01.07.2019, me të cilin ka vendosur që ta pranoj prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj Urdhërin për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat P.nr.4/2019 dt.17.101.2019 Blerim Baloku nga Peja.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se prapësimi është i bazuar për faktin se faturat kontestuese nuk i plotësojnë ë kushtet e parapara me nenin 29 të Ligjit për Procedurën përmbarimore dhe nenin 37 të LPP-së. Nga faturat në fjalë nuk mund të vërtetohet se faturat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, Faturat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit-debitorit dhe as nuk kanë protokoll zyrtar nga debitori se janë pranuar faturat e tilla në mënyrë të rregullt. Dokumenti i besueshëm nuk mund të trajtohet si i tillë nga gjykata dhe nuk mund të jetë e qartë kërkueshmëria e kredisë konform nenit 30 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar

gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të faturave të periudhës kohore 2016,2017,2018,2019 si dokument i besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: faturat. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument jo të besueshëm siç janë faturat në emër të shfrytëzimit të shërbimeve të kreditorit, pasi që nuk është dokumentuar se debitori ka pranuar këto fatura në mënyrë të rregullt, për tu dëshmuar se ky subjekt juridik ka pranuar faturat. Faturat kontestuese nuk përmbajnë nënshkrimin e debitorit, prandaj Dhoma e shkallës së dytë pranon konstatimet se këto fatura të prezantuara nga kreditori nuk i plotësojnë kushtet për tu konsideruar si dokumente të besueshme dhe të veprohet në procedurë të përmbarimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit të paraqitura në ankesë lidhur me pretendimet se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka bërë zbatim të gabuar të drejtës materiale për shkak se kreditori në fature e ka të cekur afatin e përmbushjes së detyrimit po ashtu i ka bërë me dije debitorit nëpërmjet email se kredia e tij është bërë e kërkueshme, të cilat debitori nuk i ka mohuar. Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se këto pretendime janë të pabazuara, dhe se vendimi i atakuar është i drejt dhe ligjor duke u bazuar edhe në prova të bazuara të cilat paraqesin gjendjen faktike. Dispozitat e nenit 29, 37 të LPP-së në të cilat është referuar gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e atakuar, Dhoma e Shkallës së dytë i konsideron si të drejta duke u zbatuar në tërsi e drejta materiale

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.47/22 me datë 23.08.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha